

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
REAL BAILIFF SERVICE SH.P.K

NIPT L71710039A


Nr.509 Regj
Nr.484 Prot

Tiranë, më 29.01.2019

URDHËR

“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit
Adresa: Tirane
Per dijeni: “BRAJAN-AB” Sh.p.k, Nipt L58108503O (0689085666)
Adresa: Lezhe, Shenkoll, Gajush, Lagjja Qender, Rruga e Kampit,
Per dijeni: “MLI Emulsion” Sh.p.k, Nipt K74111401A
Adresa: Lgj. “Loni Dhamo”, Blv. “Instituti”, Lushnje,



Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr. 341, date 04.12.2018 i Gjykates se Rrethit Gjyqësor Lezhë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore kërkesën e kreditorit “MLI Emulsion” Sh.p.k, Nipt K74111401A ndaj debitorit “BRAJAN-AB” Sh.p.k, Nipt L58108503O, në lidhje me titullin ekzekutiv “Fature tatimore e shitjes” Nr. 63, date 01.10.2016, me Nr. Serie 16668616.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 66 Prot, Datë 04.01.2019, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Vendimi Nr. 341, date 04.12.2018, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

Debitori “BRAJAN-AB” Sh.p.k, Nipt L58108503O, nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit per ekzekutim vullnetar te detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit “BRAJAN-AB” Sh.p.k, Nipt L58108503O, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile, si dhe të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 10031, Datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me qellim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore “BRAJAN-AB” Sh.p.k, Nipt L58108503O, me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

“REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k
PËRMBARUESI GJYQËSOR
Eris SOTIRI